



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 868/4 Prot.

Tiranë, më 30.12.2016

V E N D I M

Nr. 175, Datë 30.12.2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË MINISTRINË E
FINANCAVE “MBI ZBATIMIN E RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm si edhe Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*,

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e rregullshmërisë financiare në Ministrinë e Financave”.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT

Opinion i pakualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Ministrisë së Financave (Aparati) për vitin ushtrimor, më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.

Në gjykimin tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale lidhur me hyrjet dhe daljet në para, si dhe të buxhetit të realizuar nga Ministria e Financave (Aparati).

Baza për Opinionin:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Ministria e Financave (Aparati) dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Në vijim theksojmë monitorimin e kujdesshëm për saktësimin e vlerës së aktivitetit dhe pasivit (duke marrë shkas nga llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”).

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

GJETJA 1

Nga auditimi I shpenzimeve korrente për mallra dhe shërbime u konstatua se, sa I takon **pagesave të detyrimeve ndaj vendimeve të gjykatave**, lëvruar nga nënlllogaria 602/7900, për çështjen “LI”, në vlerë prej 90,343 mijë lekë (të ndarë për vitin 2015, në 2 urdhër shpenzime, në vlerë 81,436 mijë lekë dhe në 6/mujorin e vitit 2016 me një urdhër shpenzimi në vlerë 8,907 mijë lekë), janë kryer likuidimet me dokumentacionin e nevojshëm shoqëruar, por alokimi i tyre nuk është bërë nga kapitulli “6” “Të ardhurat nga privatizimi”, të cilat përdoren me rritje të autorizuar, por janë përdorur fondet e planifikuara të artikullit 602 “Blerje mallra e shërbime” nga kapitulli “1”. Në vijim konstatohet se, për të dy periudhat 2015 dhe 2016, “Mbi çështjen LI”, janë përcaktuar dy probleme për pagesën: së pari nga ish Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave, nuk janë trashëguar të ardhurat për të mundësuar rritjen e autorizuar për kthimin e detyrimit; dhe së dyti nuk ka një vendim gjykate për të mundësuar kthimin e kësaj vlere nga të ardhurat jashtë limitit. Këto probleme kërkojnë ndryshime në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, sa i takon alokimit të drejtë të fondeve buxhetore, ku të përfshihen dhe këto raste likuidimesh, megjithëse nga Drejtoria e Përgjithëshme të Buxhetit/Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit, drejtuar, Drejtorisë së Financës, është cituar pa mundësia e ndryshimit të udhëzimit standart të buxhetit dhe se pagesa e kësaj shume të përballohet nga fondet e buxhetit të vitit 2015, *trajtuar më hollësisht në faqet 57-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

Ministria e Financës/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, me qëllim mundësimin për rritjen e autorizuar për kthimin e detyrimit, të bëjnë të mundur përmirësimin e udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit për pjesën e të ardhurave nga shitja e pronës, të cilat nuk janë të trashëguara, duke përcaktuar në udhëzim klauzola ligjore që bëjnë të mundur krijimin e fondeve për likuidimin e vendimeve gjyqësore për kthimin e pronave.

Në vazhdim

GJETJA 2

Nga auditimi i dietave jashtë vendit, u konstatua se, urdhërat e titullarëve ishin hartuar në bazë të VKM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe UMF nr.22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”. Referuar pikës 10 të udhëzimit nr.22, datë 10.07.2013 të Ministrisë së Financave dhe nga verifikimi i fletoreve zyrtare, konfirmuar më pas edhe nga Qendra e Botimeve Zyrtare, konstatohet se, ky Udhëzim nuk është botuar deri më sot në fletore zyrtare, duke sjellë konfuzion në lidhje me zbatueshmërinë e tij, duke pasur parasysh këtu edhe nenin 117, pika 1, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin përcaktohet që: “Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrive, të institucioneve të tjera qendrore, marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare”. Gjithashtu konstatohet se, në VKM nr. 870, datë 14.12.2011, nuk jepet asnjë përkufizim në lidhje me afatin e “trajtimeve afatshkurtra”, çka krijon automatikisht një vakum ligjor, edhe për faktin se në Udhëzimin nr. 22, datë 10.07.2013, mungon saktësi juridik në lidhje me mbulimin e shpenzimeve për punonjësit e administratës, për trajtime mbi 30 ditë, duke mos përcaktuar qartë pagesën si pagë dhe pagesën si shpërblim, në varësi të mbulimit të shpenzimeve nga palët pritëse (institucione ndërkombëtare), *trajtuar më hollësisht në faqet 56-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Strukturat Drejtuese të këtij institucioni të bëjnë të mundur, përmirësimin e Udhëzimit nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, dhe botimin e tij në fletoren zyrtare, në mënyrë që jo vetëm Aparati i këtij institucioni, por të gjitha institucionet buxhetore, të mund të përfitojnë mbulimin e shpenzimeve të trajtimeve afatgjata (internship-eve) nga institucionet homologe, apo ndërkombëtare, duke përcaktuar qartë periudhën e trajtimeve afat shkurtëra dhe afatgjata, si edhe mënyrën e pagesës së këtyre shpenzimeve.

Menjëherë

Në vijim, sa i takon procesit të monitorimit të përshkruar në gjetjen nr. 1/çështja 2 “Planifikimi dhe zbatimi i buxhetit”, dhe të reflektuar në Projektraportin e Auditimit, dërguar me shkresën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr 868/2, date 29.11.2016, në Ministrinë e Financave, KLSH ka rekomanduar marrjen e masave nga ana e Ministrisë, për të reflektuar në udhëzimin “Për zbatimin e procedurave të monitorimit”, sikundër parashikohet në udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, shtimin e kërkesës për përgatitjen e raporteve të monitorimit, jo vetëm sipas programeve, por edhe sipas institucioneve

*përbërëse të një programi, të cilat në rastin e Aparatit të Ministrisë së Financave konstatohet të mos jenë përgatitur pikërisht si pasojë e këtij vakumi ligjor. Në vijim, më datë 30.11.2016, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka marrë në dorëzim, me shkresën nr. 15881/1, datë 18.11.2016, Udhëzimin nr 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, nga ku **konstatojmë** se në udhëzimin e ri, ka gjetur zbatim edhe rekomandimi i KLSH-së sa më sipër, reflektuar gjithashtu në projekt raport. Për këtë arsye, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.*

C. MASA ORGANIZATIVE

GJETJA 1

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Financës ka hartuar pasqyrat financiare përmbledhëse vetëm për degët e Thesarit dhe Aparatit të Ministrisë, duke mos përfshirë te Përmbledhësja e Thjeshtë pasqyrat financiare të 8 njësive të tjera të varësisë, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2016 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si edhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007, ku kërkohet që përveç Përmbledhësës së Thjeshtë të Pasqyrave Financiare të depozitohet edhe Pasqyra Financiare e Konsoliduar, *trajtuar më hollësisht në faqet 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Drejtoria e Financës, të marrë masa të konsolidojë përmbledhësen e pasqyrave financiare për të gjitha njësitë e varësisë, në funksion të respektimit të parimit të llogaridhënies, me qëllim mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë ministrore.

Në vijim, me qëllim kryerjen dhe realizimin e funksioneve të Drejtorisë së Financës, gjithashtu rekomandojmë ngritjen dhe funksionimin e strukturave të përshtatshme brenda kësaj Drejtorie, me përgjegjësi të përcaktuara dhe të ndara qartë, sa i takon funksioneve që lidhen me buxhetimin dhe atyre që lidhen me kontabilitetin, pasi aktualisht kjo strukturë ka mbi një vit që operon me mungesë stafi, në kushtet e një risku operacional të shtuar.

Në vazhdim

GJETJA 2

Nga auditimi i dosjeve të inventarizimit u konstatuan raste si vijon:

Me urdhrin nr. 9078, datë 16.06.2015 “Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara nga komisioni i vlerësimit të aktiveve” është caktuar Komisioni i Nxjerrjes Jashtë Përdorimit me 5 anëtarë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi, por konstatohet se, në procesverbalin e datës 19.06.2015 (ku komisioni ka rënë dakord për nxjerrjen jashtë përdorimit për 313 artikuj, me vlerë fillestare 19,506,315 lekë dhe vlerë të mbetur 5,220,872 lekë), në fakt kanë firmosur vetëm 4 anëtarë, duke mos firmosur njëri prej tyre. Gjithashtu konstatuam se, një prej anëtarëve të komisionit, njëkohësisht ka qenë pjesë edhe e procesit të vlerësimit të këtyre aktiveve. Në vijim, me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 9078/1, datë 25.06.2015, është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit e aseteve dhe inventarit të imët të dëmtuar, ndërsa “Asgjësimi i aseteve të dala jashtë përdorimit”, është miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 64, datë 05.10.2015, ku përsëri konstatohet mungesa e firmës së të njëjtit anëtar si në rastin më sipër, fakt që cënon procesin për shkak të pamundësisë së një vendimmarrjeje të drejtë, duke qenë se nuk sigurohet

minimumi prej 5 anëtarësh. Komisioni nuk duhej të vijonte me procesin, me numër të cënuar anëtarësh. Për më tepër që, nga auditimi u konstatua se, nuk ka asnjë evidencë sa i takon analizës së shkaqeve të mos pjesëmarrjes së anëtarit në Komision dhe masave që Kryetari i Komisioni (i cili në bazë të udhëzimit përzgjedh anëtarët) duhej të merrte për zëvendësimin e tij, me qëllim kryerjen e procesit në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për manaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. Nga auditimi konstatohet se, procesi i nxjerrjes jashtë përdorimit të aseteve, është shoqëruar në të gjitha rastet me fotografi, të cilat ndodhen në dosjet respektive;

Në procesverbalin mbi inventarizimin e aktiveve, të datës 06.10.2014, me qëllim fiksimit e numrit rendor të fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve, konstatohet se anëtari i komisionit, z. E.S. ka firmosur si i tillë përpara datës së urdhrit të Titullarit që e cakton si të tillë (rreth 18 ditë më parë), çfarë tregon përmbajtjen formale të këtij akti dhe riskun që procesi të jetë kryer me dy anëtarë nga tre të kërkuar, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për manaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Punonjësi ka vijuar të firmosë edhe gjendjen e magazinës, që daton më 06.10.2014, si pjesë e komisionit të inventarizimit, ende pa qenë i tillë;

Gjithashtu nga auditimi i listës së aktiveve për inventarizim u konstatua se, në disa raste mungonte firma e përgjegjësit material në kundërshtim me paragrafin 82, të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011,;

Në referencë të raportit të inventarizimit konstatohet se, janë listuar rreth 23 raste të punonjësve të larguar, por me kartela të pambyllura, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2012, ku kërkohet që punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna duhet të bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar, *trajtuar më hollësisht në faqet 28-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave, të marrin masa që në vijim, ky proces të kryhet dhe monitorohet me kujdes, me qëllim manaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangien e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë.

Në raste të tilla, të ndërpriten praktikatat formale në realizimin e procedurave dokumentare të këtij procesi, duke kërkuar në çdo rast respektimin dhe pjesëmarrjen e personave të ngarkuar me këtë proces. Mungesat e çdo anëtari duhet të bëhen shkak për ndërprerjen e procesit deri në zëvendësimin e personit që nuk ka mundësi të marrë pjesë në finalizimin inventarizimit. Çdo lëvizje duhet të jetë bazuar në vendimmarrje institucionale.

Me qëllim mos cënimit e efikasitetit të punës, gjithashtu të merren masa që për punonjësit e larguar, të cilët kanë në ngarkim aktive, të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për dorëzimin e këtyre aktiveve dhe në rast të mos zbatimit të nxirren përgjegjësitë dhe të merren masat e nevojshme.

Në vazhdim

GJETJA 3

Kemi konstatuar se, të dhënat e publikuara e të gjeneruara nga databaza e Thesarit në faqen e Ministrisë së Financave¹, për vitin 2015, nuk reflektojnë transaksionet reale. Vetëm për të dhënat rreth transaksioneve të Apartit të Ministrisë së Financave, konstatuam 418 transaksione të përsëritura, e konkretisht: dubluar 73 raste në shumën totale 773,856,793 lekë; përsëritur 3 herë, 19 raste për shumën 17,544,445 lekë; përsëritur 4 herë 18 raste, për shumën 44,148,784 lekë,

¹ <http://www.financa.gov.al/raportime/thesari/pagesa-te-kryera-nga-drejtoria-e-pergjithshme-e-thesarit/pagesat-e-kryera-2015>

përsëritur 5 herë 25 raste, për shumën 408,458,665 lekë dhe përsëritur 6 herë, 3 raste për shumën 74,715,416 lekë. Kjo situatë e konstatuar cënon në vetvete qëllimin e “Programit të Transparencës” së Ministrisë, ku përmes tij, Ministria synon të ndërtojë dhe rrisë transparencën institucionale, mbështetur mbi nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Nga ana tjetër, ndërkohë që gjatë vitit 2015 e në vijim, investimet e Ministrisë së Financave për zhvillimin dhe suportin e Sistemit të Thesarit kanë qenë të konsiderueshme, gjenerimi të dhënave nga ky Sistem (i reflektuar në faqen e MoF) jo saktë, vë në pikëpyetje efikasitetin dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve të investuara për zhvillimin tij. Sa më sipër në funksion edhe të sigurimit të informacionit për palët e interesit, si pjesë e konceptit tashmë të njohur dhe pranuar gjerësisht në vendet e BE-së e më gjerë mbi “**Qeverisjen e hapur**”, koncept ky që në gjykimin tonë duhet të gjejë zbatim veçanërisht në Ministrinë e Financave, në kuadër gjithashtu të respektimit të shtyllave të **Kodit të Transparencës Fiskale**, *trajtuar më hollësisht në faqet 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave, që bëjnë konfigurimin e sistemit të Thesarit, të marrin masa në vijim që kjo databazë, jo vetëm të mundësojë reflektimin e situatës reale të shpenzimeve në përputhje me integritetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoritetit publik por duke qenë e tillë të ofrojë bazë të shëndoshë informacioni për palët e interesit. Gjithashtu investimet e kryera në sistemet e Thesarit, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të tij, duhet të reflektohen në të dhëna dhe raporte, të cilat ofrojnë një pamje gjithëpërfshirëse të aktiviteteve fiskale të sektorit publik, si një ndër parimet kryesore të “Transparencës fiskale” (referuar Kodit të Transparencës Fiskale të FMN-së).

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 4

Nga auditimi i realizimit të buxhetit të vitit 2015, për shpenzimet korrente për “Mallra dhe Shërbime”, konstatohet se fillimisht u planifikua, në nivele pothuajse të përafërta me vitin ushtrimor paraardhës, konkretisht 1,503,939 mijë lekë, ose 17,400 mijë lekë më pak se fakti i vitit 2014 (rreth 1% më pak), por në vijim buxheti u rishikua, duke u rritur në 2,797,214 mijë lekë (ose rreth 184% më shumë se viti 2014 dhe rreth 19% nga buxheti fillestar i vitit 2015), nga të cilat u realizua në masën 2,725,871 mijë lekë (ose realizuar rreth 98%). Impaktin më të madh në këto shtesa të konsiderueshme e kanë pasur shpenzimet e ekzekutuara me VKM të veçanta, si ato që lidhen me pagesa të vendimeve të **Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) (për periudhën objekt auditimi 3,049 milionë lekë, nga të cilat rreth 76% likuiduar në vitin 2015),** likuidime që Ministria e Financave bën për rritjen e aksioneve të Republikës së Shqipërisë, **në Bankën e Detit të Zi (per periudhën objekt auditimi rreth 393 milionë lekë nga të cilat rreth 85% likuiduar në vitin 2015),** apo pagesa për shërbimin e asistuar në lidhje me administrimin e doganave të Shqipërisë kundrejt **Crown Agents** (rreth **692 milionë lekë** gjatë vitit 2014). Këto shpenzime të paparashikuara në buxhetin fillestar të Ministrisë së Financave, duke u miratuar rast pas rasti me VKM, mbeten deri diku jashtë autoritetit të Aparatit, nga buxheti i të cilit në përfundim këto fonde ekzekutohen. Sa më sipër gjithashtu tregojnë formalitetin e procesit të planifikimit që si i tillë rezulton në fakt të ndryshohet vazhdimisht, duke mos u bërë një mjet i besueshëm i reflektimit të politikave fiskale të vetë institucionit, *trajtuar më hollësisht në faqet 57-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Drejtoria e Financës të paraqesë këtë kategori shpenzimesh, në relacionet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare të Aparatit, duke konsideruar nivelin e materialitetit të tyre relativisht të lartë. Duke konstatuar raste kur shpenzimet janë kryer nga buxheti i Aparatit (kjo për vitin 2014, e sistemuar në vitin 2015), por ndërkohë aseti për të cilin është investuar (psh rasti i **Crown Agents**) i takon doganave, të merren masa që në të gjitha rastet në të ardhmen, shpenzime të tilla të kryhen në raport të drejtë me parimet e regjistrimeve kontabël, duke u kanalizuar shpenzimet në ato institucione të cilat përfitojnë asete nga kryerja e këtyre shpenzimeve dhe jo tjetërkund.

Gjykojmë se nevojitet kujdes dhe përgjegjshmëri në “formulimin” e buxhetit, nga strukturat/struktura që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, për të cilat/cilën rekomandojmë eliminimin e planifikimeve thjesht formale, dhe mbajtjen parasysht të kryerjes së parashikimeve të besueshme, duke kryer analiza të faktorëve social dhe ekonomike, si edhe duke u konsideruar të gjitha implikimet e mundshme të këtyre rregullave fiskale, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme në buxhete gjatë vitit fiskal.

Në vazhdim

GJETJA 5

Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të Ndryshëm”, në pasqyrat financiare të Aparatit u konstatua se, gjendja e kësaj llogarie prej 91,660,900 lekë, konsiston në detyrime të krijuara që prej vitit 2005, të cilat lidhen me 8 raste individësh, të cilët kanë privatizuar pronën shtetërore nëpërmjet ish AKP-së (Agjencia e Kthimit të Pronave) dhe Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike. **Nga auditimi u konstatua se shumica e reflektuar në llogarinë Debitorë të ndryshëm nuk është e sakta.** Nga kryqëzimi i informacioneve, të marra edhe nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike (DDPP), e cila mbulon ndjekjen dhe monitorimin e këtij procesi, u konstatua se vlera totale e detyrimit, konfirmuar nga kjo drejtori, është 468,563 lekë dhe jo 91,545,029 lekë sikundër deklarohet në pasqyrat financiare të Aparatit të Ministrisë së Financave, me një gabim material për diferencën (ende të pakonfirmuar nga të dy Drejtoritë bashkërisht), duke treguar gjithashtu mungesë përgjegjshmërie, bashkëpunimi dhe koordinimi mes dy drejtorive të përfshira në proces. Nga ana e Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike nuk na është vënë në dispozicion asnjë konfirmim sa i takon statusit të pronësisë së këtyre aseteve, të cilat referuar vendimeve respektive të gjykatës, rezultojnë të jenë ende në pronësi të blerësve (pra jo pronë shtetërore), *trajtuar më hollësisht në faqet 25-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, të marrin masa të menjëhershme për të saktësuar vlerën e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila nga auditimi u konstatua të raportohet rreth 195% më e lartë nga sa e paraqet si vlerë Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike. Raportimi i saktë financiar duhet t’i shërbejë në mënyrë efektive procesit të vendimmarrjes, i cili mbështetur në informacion të shtrembëruar riskon gjithashtu të cënohet.

Në vijim rekomandojmë që Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike të marrë masa të menjëhershme, për të identifikuar statusin e pronave me të cilat lidhen këto detyrime si edhe për këto raste por edhe të tjera të mbajë një regjistër të veçantë, i cili të azhurnohet në mënyrë periodike (muajore). Pas konfirmimit nga ZVRPP-të respektive, se është kryer çregjistrimi i pronësisë nga ish-blerësit në përputhje me vendimet e gjykatës së formës së prerë dhe se pronat janë regjistruar si pronë shtetërore, kjo Drejtori të njoftojë Drejtorinë e Financës, e cila ka

përgjegjësinë që të kryejë sistemimet kontabël në përputhje me vlerat e konfirmuara bashkërisht dhe regjistrimin në pasqyrat financiare të Aparatit të pasurisë shtetërore të munguar.

Me qëllim vërtetësinë e pasqyrave financiare, rekomandojmë që Drejtoria e Financës në mënyrë periodike (muajore) të kërkojë informacion nga drejtoritë/njësitë respektive, me qëllim verifikimin dhe pasqyrimin e drejtë të vlerës së zërave të Aktivit dhe Pasivit të Bilancit Kontabël.

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 6

Nga auditimi u konstatua se, në zërin “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara të Dëmtuara” janë regjistruar aktive të konstatuara të humbura, të mbartura në Bilancin Kontabël të Aparatit si të tilla që prej vitit 1998, për të cilat, me shkresën nr. 4883, datë 24.09.1998 të Ministrit të Financave, është dërguar në Prokurorinë e Rrethit, Tiranë, denoncimi “Mbi dëmtimet dhe vjedhjet në datat 13-14.1998”, i cili nuk ka vijuar të ndiqet si proces. Nga auditimi u konstatua se, bëhet fjalë për 29 objekte (si kompjutera telefona, aparat faksi, dollape hekuri etj), në shumën totale prej 1,494,927 lekë, regjistruar në kontabilitetet nën zërin “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara” prej 1,401,359 lekë dhe diferenca prej 93,568 lekë, në inventar ekonomik), *trajtuar më hollësisht në faqet 24-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Nëpunësi i Parë Autorizues në Ministrinë e Financave, të marrë masa për nxjerrjen e një urdhri/udhëzimi rreth trajtimit të këtyre objekteve të konstatuara si “të vjedhura”, e që rezultojnë pa shpresë arkëtimi, ku të analizohet me kujdes situata dhe në bazë të sa më sipër të vendosen kriteret për mbajtjen ose jo në bilanc e tyre, për vitet në vijim. Udhëzimi të jetë unifikues për të gjitha institucionet dhe entet publike që kanë aktive të tilla, por që heqja nga bilanci të bëhet vetëm me aprovim të Ministrisë së Financave, si nga pikëpamja e miratimit të procedurës ashtu edhe kontabilizimit respektiv.

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 7

Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatojmë se, është përfshirë në zërin e “Fondeve Buxhetore kapitale” shuma prej 237,846,600 lekë, dhe jo 167,512,600 lekë, sipas celjes së thesarit, duke reflektuar me pa të drejtë 70,334,000 lekë më shumë në “Arkëtimet e vitit cash”. Nga verifikimi konstatojmë se kjo diferencë i takon artikullit 231, për projektin GM10013 – “Projekti për mbështetjen dhe zgjerimin e Thesarit të Shqipërisë” për të njëjtën vlerë, e cila është paraqitur në planin vjetor, por që kjo shumë nuk është bërë çelje në thesar, gjatë vitit 2014. Si e tillë nuk duhej të reflektohej në Pasqyrën e lëvizjes së parasë. Për sa më sipër konstatojmë se Pasqyra e Lëvizjes në Cash për vitin 2014, edhe pse paraqet drejt rezultatin, nuk reflekton drejtë transaksionet financiare, *trajtuar më hollësisht në faqet 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I ulët

REKOMANDOJMË

Në vijim Drejtoria e Financës të tregohet e kujdesshme në reflektimin e shifrave të sakta (edhe pse në rastin konkret pa impakt në rezultatin vjetor), në pasqyrat financiare, duke konsideruar

rëndësinë që pasqyrat financiare kanë në procesin e vendimmarrjes, mbi shpërndarjen dhe përdorimin e fondeve buxhetore.

Në vazhdim

GJETJA 8

Nga auditimi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) u konstatua se, në vendimet që datojnë në vitin 2014 e tutje, parashikohet: *“Interesi për vonesën, ku Gjykata e shikon të arsyeshme që shkalla e interesit për vonesën e pagesës duhet të bazohet mbi shkallën e huasë marxhinale të Bankës Qendrore Evropiane, së cilës i duhen shtuar pikë tre përqindësh”*. Në vijim na rezultoi se, gjatë vitit 2014, 2015 dhe 2016 janë ekzekutuar vendime e kësaj gjykatë, duke përfshirë edhe vlerën e penaliteteve njëkohësisht, shumat e të cilave rezultojnë të paidentifikuara me ndonjë kod të dedikuar llogarie thesari (por janë të përfshira në të njëjtin kapitull me detyrimin “e pastër”). Këto vendime, duke u ekzekutuar përtej afateve të parashikuara në vendimet respektive të GJEDNJ, kanë përlllogaritur penalitete likuiduar në vitin 2015, **për shumën materiale prej 28,831,573 lekë**, ekzekutuar nga llogaria 602 e Aparatit të Ministrisë së Financave, *trajtuar më hollësisht në faqet 31-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

Drejtoria e Financës, gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, në rastin e shpenzimeve materiale (siç janë shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ), të paraqesë informacionin në shënimet shpjeguese, duke u bazuar në konceptin e materialitetit, ku “zërat jo materialë mund të paraqiten të grupuar”, në referencë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit SKK 2, dhe të kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik SNKP 1 (IPSAS1).

Në funksion të sa më sipër, duke konsideruar trendin rritës të këtij zëri (aktualisht rreth 1,551 milionë lekë ose rreth 91% e total llogarisë 602), rekomandojmë gjithashtu, hartimin dhe miratimin e një Udhëzimi të brendshëm “Për Procedurat e Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ” nga ana e Ministrisë së Financave, ku të përcaktohen qartë detyrat, përgjegjësitë dhe afatet për ekzekutimin e këtyre pagesave, duke sugjeruar **përdorimin e metodës FIFO**, si një ndër metodat efektive për minimizimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Në vijim, me qëllim rritjen e transparencës së informacionit kontabël dhe përdorimin e tij në proceset të vendimmarrjes, rekomandojmë çeljen me kod të veçantë të një llogarie në sistemin e Thesarit për shumën e penaliteteve dhe jo reflektimin e tyre si pjesë e detyrimit që rrjedh nga vendimi.

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 9

Nga auditimi u konstatua se, është prekur Fondi i Kontigjencës, për pagesa ndaj vendimeve të Gjykatës Evropiane të të drejtave të Njeriut, dhe për pagesa të Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe jo për nevojën e financime të reja, apo për të përballuar efektet e mosrealizimit të ardhurave, sikundër e kërkon Ligji organik të Buxhetit, i ndryshuar (nëfakt është prekur programi 04940 – Kontigjencë për ruajtjen e deficitit). Konstatohet se në sistemin e Thesarit, Fondi i Kontigjencës manaxhohet vetëm nëpërmjet 4 programeve si më poshtë:

Programi 049420 – Kontigjencë për rritjen e investimeve;

Programi 04930 – Kontigjencë për rritje pensionesh;

Programi 04940 – Kontigjencë për ruajtjen e deficitit; dhe

Programi 04950 – Kontigjencë për rritjen e pagave dhe Fondi i Vecante i Pagave,

ku asnjë nga programet e mësipërme nuk i dedikohet kësaj kategorie shpenzimesh, sikundër vetë Akti Normativ nr.1, datë 29.07.2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015” e kërkon e që është: “Fondi i Kontingjencës për ekzekutimin e pagesave për detyrime ndërkombëtare”, *trajtuar më hollësisht në faqet 17-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, të marrin masa për çeljen e një kodi programi, të dedikuar sa i takon “Fondit të Kontingjencës për ekzekutimin e pagesave për detyrime ndërkombëtare”, ku të reflektohen pagesat për këtë qëllim dhe jo ndryshe, sikundër ka ndodhur deri tani.

Në vazhdim

GJETJA 10

Nga auditimi i nën/llogarisë 602/1099 “Likujtime të Shërbimit të asistuar në lidhje me administrimin e Doganave të Shqipërisë (C A)”, për faturat e lëshura nga “C A L” dhe të pranuar nga Këshilli i Menaxhimit të Programit për **vitin 2014**, në vlerë **692,258 mijë lekë**, ka rezultuar:

a. Këshilli i Menaxhimit të Programit, i cili do të mbikqyrte këtë kontratë, ka urdhëruar në çdo rast pagesën e faturave mujore, para se të merte raporte nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbi ecurinë e kontratës në teren, pra pa miratuar monitorimin e plotë të treguesve dhe të performancës së marrëveshjes, pra është lejuar pagesa e tyre bazuar në raporte të njëanshme.

b. Ka kaluar likuidimi me artikullin 602 “Blerja e 10 makinave”, e cila duhet të likuidohet nga artikulli 231.

c. Në vitin 2015 ky lloj shërbimi është likuiduar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, pa kaluar faturat dhe raportet e monitorimit për këtë shërbim në Ministrinë e Financës, *trajtuar më hollësisht në faqet 60-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Nga strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave, të ndërmerret një auditim performance për “Shërbimin në lidhje me administrimin e Doganave të Shqipërisë nga “C A”, në mënyrë që të konkludohet për efektivitetin, ekonomikitetin dhe eficientësinë e këtij shërbimi, në funksion të rritjes së të ardhurave dhe uljes së shpenzimeve doganore.

Menjëherë

GJETJA 11

Nga auditimi në Aparatin e Ministrisë së Financave për periudhën 2014, 2015 dhe 6/mujorin e vitit 2016 për artikullin **602 “Blerje mallra dhe shërbime”**, të ndara me nën/artikuj si në tabelën e paraqitur në faqen 58, të Raportit të Auditimit na rezultoi se:

Për vitin 2015 “Blerje mallra dhe shërbime” janë harxhuar më shumë se viti 2014, në programin 01110 “Blerje mallra dhe shërbime për aparatet” në këto nën zëra të 602:

- Pagesa për dieta brenda vendit prej 574 mijë lekë, ose 21% më shumë;
- Pagesa për dieta jashtë vendit prej 3,038 mijë lekë, ose 26% më shumë;
- Pagesa për blerje kancelari e materiale prej 711 mijë lekë, ose 15% më shumë;
- Pagesa për blerje shërbime të ndryshme prej 33,048 mijë lekë, ose 45% më shumë.

- Pagesa për të tjera shërbime prej 4,082 mijë lekë, ku vlen për t'u përmendur në këtë grup zërash larje e automjeteve, që për këtë vit është rritur për 597 mijë lekë, ose sa 5-fishi i një viti më parë;
- Pagesa për pritje përcjellje prej 289 mijë lekë, ose 17% më shumë;
- Pagesa për njoftime e të tjera prej 3,640 mijë lekë, ose 6.3 herë më shumë;
- Pagesa për mirëmbajtje automjeti prej 512 mijë lekë, ose 55% më shumë, trajtuar më hollësisht në faqet 57-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Nga strukturat drejtuese të këtij institucioni, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, të tregohet kujdes dhe përgjegjshmëri gjatë planifikimit, duke u analizuar nën/zërat e artikullit 602 “Blerje mallra dhe shërbime për Aparatin e MoF” në mënyrë të tillë që të mos lejohen tejkalime të tilla shpenzimesh në zëra të ndryshëm të 602 (që rezultojnë nga viti në vit me ndryshime disa herë më shumë), për të mos vënë në dyshim planifikimin e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 12

Nga auditimi u konstatua se, referuar të dhënave mbi strukturat organike të MF, rezulton një numër i konsiderueshëm vendesh vakante, vazhdimisht në rritje, të cilat janë konsideruar në planifikimin fillestar, por në vijim me rishikimin me akte normative fondet e papërdorura për këtë zë shpenzimi, janë rishpërndarë mes zërave të tjerë buxhetorë. Ky fenomen ka ndodhur që nga viti 2013 deri në vitin 2016, çfarë gjithashtu tregon për planifikime jo reale të ndryshimeve strukturore të cilat më pas nuk realizohen.

Në vijim, performanca e disa drejtorive pa asnjë punonjës, me mungesë të vazhdueshme stafi, si edhe me normë të lartë të qarkullimit të stafit, riskon mos kryerjen me eficiencë të funksioneve të këtyre sektorëve në vetvete (p.sh. rasti i hartimit gabim i kontratave për punonjës të përkohshëm – specialistë, ku për vitet - objekt auditimi, ka vijuar të mbështetet mbi një bazë ligjore të gabuar).

Nën gjykimin tonë, nevoja për këto struktura në organikën e institucionit, duhet të diktohet nga motive thelbësore, që lidhen me përmirësimin e performancës dhe përmbushjen e detyrave, çfarë në fakt nuk rezulton, pasi konstatojmë që edhe pse strukturat janë pothuajse të paplotësuara, fondi për funksionimin e tyre vijon të çelet çdo vit buxhetor, për të mos u realizuar më pas. Gjykojmë se mos qëndrueshmëria e stafit është politike e gabuar në burimet njerëzore, që dobëson performancën dhe sjell keqmanaxhim të fondeve, pasi për të përgatitur specialistët e fushës, niset nga “pika 0”, ndërsa eksperiencia dhe përvoja janë garanci për sinergjinë institucionale si dhe kusht njerëzor-institucional që të rritet cilësia e punës, *trajtuar më hollësisht në faqet 40-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

REKOMANDOJMË

Ministria e Financave në bashkëpunim me DAP duhet të marrin masa të menjëhershme, që vendet vakante të plotësohen nga punonjës që përmbushin kriteret sipas pozicionit. Të bëhen thirrje të vazhdueshme rekrutimi, të hapura dhe transparente. Urdhrat e Kryeministrit për strukturën dhe organikën e Ministrisë duhet të zbatohen dhe të arrihen objektivat për shkak të së cilave është parë e arsyeshme shtesa në burime njerëzore.

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 13

Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të punonjësve u konstatua se, për disa raste të punonjësve me kontratë të përkohshme pune, dosjet e këshilltarëve kanë qenë pjesërisht jo të plota, pasi mungojnë një pjesë e dokumenteve të kërkuara; si edhe disa nga dosjet e punonjësve me kontratë të përkohshme të larguar nuk janë të ruajtura nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në kundërshtim me sa parashikohet në VKM nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, *trajtuar më hollësisht në faqet 40-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Në vijim, sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa të plotësojë në mënyrë korrekte me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dosjet e personelit të angazhuar me punë në Ministrinë e Financave, me qëllim saktësinë dhe transparencën sa i takon stafit të angazhuar me punë në këtë subjekt.

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 14

Nga auditimi u konstatua se, disa nga punonjësit, të cilët janë punësuar me kontratë pune të përkohshme kanë vijuar të rinovojnë kontratat me afate 2, 3 mujore apo 12 mujore, praktikë kjo që riskon të shndërrohet në një fenomen të përhershëm, si një praktikë paralele dhe mbivendosje e funksioneve institucionale të DAP. Rekrutimet për punonjës me afat të shkurtër nuk japin garanci nëse ata do të vijojnë në të njëjtin pozicion apo jo. Ministria e Financave nevojitet të tregojë, përmes politikave të burimeve njerëzore dhe hallkave të tjera, se rekrutimi dhe ngritja e cilësisë së punës së stafit që vjen rishtazi në këtë institucion, është një nga prioritetet e punës së vet. Nën gjykimin tonë, nëse fillohet gjithnjë nga e para sa i takon rekrutimit të stafit, sa më sipër do të rezultojë në shpenzim të fondeve pa efekte pozitive, duke humbur gjithashtu kohë dhe duke mos përmbushur detyrat, për të cilat ky staf është marrë në punë, *trajtuar më hollësisht në faqet 40-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I lartë

REKOMANDOJMË

Ministria e Financave, në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike (në varësi të frekuencës së nevojës) të monitorojë me rigorozitet ndjekjen e kërkesave që vetë kjo e fundit bën te DAP, me qëllim minimizimin deri në eliminim të fenomenit të plotësimit të vendeve vakante me punonjës të përkohshëm, si edhe duke qenë aktiv dhe jo pasiv në plotësimin e vendeve, në kuadër të mos cënimit të proceseve të punës që lidhen me këto pozicione.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në vijim të jetë e kujdesshme në mbajtjen e një baze të dhënash ku të reflektohen të gjitha hapat e ndjekura për sa më sipër dhe të nxirren shkaqet rast pas rasti rreth mosplotësimit të vendeve.

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 15

Nga auditimi konstatojmë se, nuk mbahet bordero të veçantë për punonjësit me kontratë të përkohshme, në kundërshtim me Udhëzimin plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 15.1.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, pika 25, duke vijuar t’i mbajë liste pagesat bashkë, si për punonjësit e përhershëm edhe për ata të përkohshëm. Këto listëpagesa janë

dorëzuar në Thesar pa u nënshkruara nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Përgjatë vitit 2014, pesë (5) punonjës që fillimisht kanë kaluar në listë pritje nga sektorë të ndryshëm, për arsyen e suprimimit të pozicionit dhe ndryshimeve në organikë, janë rikthyer në vendin e punës me vendim gjykate të formës së prerë, për të cilët Ministria ka likuiduar një pagesë totale për detyrimin, në shumën prej 1,164,066 lekë.

Në listë pagesën e muajit Qershor të vitit 2014, kemi konstatuar një rast me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme pune, me afat 5 ditë, nga të cilat dy ditë janë paguar si ditë të plota pune, pa asnjë dokument verifikues të kthimit të punonjësit në punë.

Nga auditimi i listë pagesave u konstatua se, në një rast (për periudhën nga 1 Nëntor 2014, deri në 1 Nëntor 2016), një punonjës nuk ka paraqitur llogarinë bankare ku duhet t’i kalojë paga mujore, dhe si pasojë shuma totale e pagave mujore për të gjithë periudhën prej 1,309,900 lekë nuk është tërhequr nga punonjësi, duke u mbartur si detyrim në pasqyrat financiare të institucionit, e duke u kontabilizuar në llogarinë 42 “Personeli e Llogari të lidhura me to”, e cila në bilanc nuk kishte shpjeguesin e përbërjes. Kjo llogari në fakt reflekton më së shumti shpenzimet e Dhjetorit për t’u likuiduar në Janar dhe jo detyrime afatgjate (mbi një vit në rastin konkret). Gjatë periudhës së auditimit, Drejtoria e Financave e saktësoi regjistrimin kontabël të shumës së sipër përmendur, por fenomeni vazhdon, pasi punonjësi kërkon të kthehet në vendin e punës që ka qenë përpara se të largohet nga puna, e drejtë kjo e njohur me vendim gjykate të formës së prerë, *trajtuar më hollësisht në faqet 40-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I Mesëm

REKOMANDOJMË

Të merren masa që, për punonjësit me kontratë të përkohshme të mbahet bordero e veçantë dhe listëpagesat e institucionit në çdo rast të nënshkruhen edhe nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore.

Me qëllim përmirësimit të punës dhe rritjen e përdorimit efektiv të fondeve buxhetore, strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave të mos ndërmarin veprime për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me institucionin, të paargumentuara dhe mbështetura në dispozitat ligjore përkatëse në fuqi.

Për të verifikuar kthimin e parakohshëm në punë (përpara afatit të parashikuar në raportin mjekësor), nevojitet një shënim shpjegues tek listëprezenca, firmosur edhe nga vetë punonjësi.

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 16

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për investime e projekte janë konstatuar mangësi dhe të meta të ndryshme në drejtim të: mosplotësismit të saktë të regjistrimit të realizimit të prokurimit publik të vitit 2014; mos ngritjes së njësisë së prokurimit për vitin 2014; mos argumentimit konform legjislacionit për shtesën e kontratës së prokurimit; mos vendosjes së kërkesave kualifikuese në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe mos kërkimi i dokumenteve vërtetuese ligjore në disa prokurime, përgjatë periudhës së audituar; mos anulimi i procedurave të prokurimit nga ana e KVO-së në dy raste, me një OE, megjithëse nuk plotësohen gjithë kërkesat kualifikuese; mos përcaktimi i saktë i penalitetit sipas afatit dhe llojit të kontratës. Nga auditimi, të prokurimeve me blerje të vogla, është konstatuar se, ndërsa interesimi i operatorëve ekonomik fillimisht është i lartë, më pas rezulton që ata të tërhiqen nga gara, pa dhënë asnjë argumentim, e për pasojë konstatohet zgjatje e procedurës për shpalljen e fituesit, *trajtuar më hollësisht në faqet 79-87 dhe faqet 96-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I ulët

REKOMANDOJMË

Nga ana e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të merren masat për eliminimin e këtyre mangësive dhe të metave në të ardhmen, me qëllim realizimin e procedurave të prokurimit në përputhje me qëllimin e legjislacionit të prokurimit publik.

Sa i takon konstatimit të rasteve ku operatorët ekonomikë tërhiqen nga gara konkurruese gjatë procesit të tenderimit, Autoriteti Kontraktor në bashkëpunimin me Agjencinë e Prokurimit Publik, të koordinojnë punën me qëllim gjetjen e hapësirave ligjore, për të mundësuar minimizimin e zgjatjes së procedurave.

Në vazhdim

GJETJA 17

Nga auditimi i prokurimeve me objekt “Blerje e biletave ajrore për transportin ndërkombëtar” të realizuara me procedurë emergjente me blerje të vogla si dhe blerjen e këtij shërbimi, të realizuara me konkurse të mini-kontratave, si derivate të procedurës së hapur “Marrëveshjes Kuadër nr. 1045/9 datë 11.04.2016”, rezulton sa vijon:

Procedurat emergjente me objekt “Blerje e biletave ajrore për transportin ndërkombëtar”, për vitin 2015, nuk janë realizuar në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke u realizuar me vlerë më të madhe se 100,000 lekë, me justifikimin se komisioni i blerjeve të vogla, nuk ka kohë të mjaftueshme për të operuar në kohë për blerjen e këtij shërbimi, duke zgjedhur mënyrën shkresore dhe jo atë elektronike, ku biletat janë rezervuar drejtëpërdrejtë sipas rastit në agjensi të vetme turistike, duke shmangur konkurrencën.

Ftesa për ofertë, nga komisioni i mini-kontratës, është paraqitur në formë shkresore dhe **jo on-line**, në shkelje të kontratës nr. 1045/9 datë 11.04.2016 neni 4 pika 4.3, e cila kërkon që: *“Kurdoherë që paraqitet nevoja për shërbim autoriteti kontraktor duhet të përgatisë ftesat për ofertë dhe duhet t’ja dërgojë elektronikisht të gjithë operatorëve ekonomikë, palë në marrëveshje kuadër (...)”*.

Nga auditimi i mini-kontratave, të procedurave shkresore në dosjet fizike respektive, ka rezultuar se në të gjitha procedurat e audituara për ofertat e paraqitur nga operatorët ekonomikë, të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor, është pranuar nga komisioni i mini-kontratave, vetëm vlera e çmimit, në kundërshtim me Udhëzimin e APP-së, nr.6 datë 27.01.2015

Nga auditimi u konstatua se, për blerjen e 13 biletave për periudhën 11.04.2016 deri 28.06.2016, brenda zonës së Evropës me linjë transit rezulton një vlerë e paguar prej 1,006,661lekë, ose afërsisht një biletë ka kushtuar 82,050.846 lekë. Pra dukshëm evidentohet se, çmimet janë të larta si dhe AK kontakton me operatorët ekonomik gati 2 deri 1 ditë përpara, duke e bërë deri diku, blerjen e biletës nga “sot për nesër”, duke konstatuar kështu *përdorim pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike, trajtuar më hollësisht në faqet 105-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Për pjesën e mbetur të ekzekutimit të marrëveshjes kuadër, të lidhur me operatorët ekonomik të përzgjedhur, Autoriteti Kontraktor të marrë masa që, Komisioni i mini-kontratave të realizojë procesin e përzgjedhjes dhe monitorimim në procedurën e Minikonkursit për blerjen e biletave ajrore, në mënyrë që ftesa për Minikonkursin të jetë online dhe jo në formë shkresore, që do të thotë se, **AK duhet t’jua paraqesë kërkesën on-line operatorëve ekonomikë të përzgjedhur** nga Marrëveshja Kuadër, si edhe marrja e ofertës nga OE në drejtim të Autoritetit Kontraktor të

jetë gjithashtu on-line, me qëllim rritjen e transparencës së procedurës së blerjes së këtij shërbimi.

Gjithashtu rekomandojmë që Komisioni i Minikonkursit të monitorojë në web-in e kompanive ajrore që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ditën që paraqitet oferta nga operatorët e përzgjedhur nga MK. Nga operatori ekonomik fitues nga Mini konkursi, nevojitet të paraqitet BSP (Billing and Settlement Plan Manual) e miratuar nga IATA.

Menjëherë dhe në vazhdim

GJETJA 18

Nga auditimi në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) dhe dokumentacionin bashkëngjitur dosjes fizike, u shqyrtua tenderi me objekt **“Sigurimi i shërbimit të Konsulencës ligjore për Eurobondin”**, “Shërbim konsulence”, procedurë specifike, e realizuar për herë të dytë nga Qeveria Shqiptare (kontrata e 1-rë me nr. 277/16 datë 01.04.2010), me qëllimin që Eurobondi të emetohet për të financuar buxhetin e shtetit. Nga auditimi u konstatua se, në bazë të Urdhrit nr. 1969, datë 06.02.2015 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike-termave të referencës dhe llogaritjen e fondit limit të kontratës me objektin e mësipërm”, e gjithë korrespondenca e realizuar me qëllim testimin e tregut, për llogaritjen e fondit limit, nga grupi i punës, si dhe vendosjen e kritereve me partnerë të huaj, është e arkivuar në gjuhën angleze, në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimeve publike, ku kërkohet përkthimi i materialeve edhe në gjuhën shqipe. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, ky tenderim është realizuar në *Procedurën e 3-të, si pasojë e anulimit të procedurës së 1-rë dhe të 2-të*, pasi është parë që kandidatët pjesëmarrës të huaj kanë paraqitur mangësi në dokumentacionin ligjor që lidhen më së shumti me kapacitetet teknike, eksperiencën të ngjashme (mos faktimi me dokumentacion si fatura tatimore/vërtetim realizim kontrate), etj. *Ndërsa në Procedurën e 3-të, “Sigurimi i shërbimit të Konsulencës ligjore për Eurobondin”*, me procedurë “Negocim pa shpallje”, me fitues operatorin ekonomik të huaj “D..”, me vlerë oferte 16,432,150 lekë pa TVSH, rezultoi se, nga ana e KVO-së, konstatohet se është pranuar dhe kualifikuar operatori ekonomik i huaj anglez, me seli në Dubai, me dokumentacion të noterizuar dhe përkthyer nga përkthyesi zyrtar i Ministrisë së Financave, nga ku evidentohet mungesa e Vulës Apostile, ekzistenca e të cilës do të bënte më të besueshëm pjesën e dokumentacionit ligjor, në përputhje më bazën ligjore mbi të cilën operohet në territorin shqiptar. Gjithashtu në bazë të Konventës së Hagës, datë 05.11.1961, kjo vulë është e vlefshme për çdo kandidatët garues të huaj, të cilët nuk kanë seli rezidente në territorin shqiptar, *trajtuar më hollësisht në faqet 92-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Autoriteti kontraktor të marrë masa, që të gjithë operatorët e huaj të cilët janë pjesëmarrës në procese prokurimit, duhet të paraqesin dokumentacionin ligjor të shoqëruar me Vulën Apostile, pasi ekzistenca e saj do të bënte më të besueshëm pjesën e dokumentacionit ligjor në përputhje më bazën ligjore më të cilën operohet në territorin shqiptar, ku gjithashtu në bazë të Konventës së Hagës, datë 05.11.1961, kjo vulë është e vlefshme për çdo kandidatët garues të huaj, që nuk ka seli rezidente në territorin shqiptar.

Në vazhdim

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, në ligjin nr. 152/2013, datë 13.05.2013 “Statusi i

nëpunësit civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Titullarit të institucionit, që referuar shkeljeve të konstatuara në procesin e nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit, por edhe aspekteve të tjera që në gjykimin tonë sjellin risk operacional, si edhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, të vendosë marrjen e masave administrative dhe disiplinore në raport me këto shkelje si edhe të njoftojë KLSH-në për masat e marra.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R